

## Vendim nr. 30 datë 05.02.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zacaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 05.02.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 25 (P) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** POLO SINO

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 103, datë 26.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë; nr. 2013 (86-2019-2334), datë 27.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-2912, datë 04.07.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së

Parë Vlorë kundër palës së paditur, Zyrës Përmbare Vlorë, me objekt detyrimin e palës së paditur për të vënë në dispozicion të tij kopje të vendimit nr.160, datë 14.04.1983 (*vendimi nr. 160/1983*) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr.677, datë 05.05.2016 (*vendimi nr. 677/2016*), ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë si të bazuar në ligj dhe në prova, duke përcaktuar detyrimin e palës së paditur, Zyrës Përmbare Vlorë, për të vënë në dispozicion të kërkuarit një kopje të vendimit nr.160/1983 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 08.07.2016, pasi nuk është ankimuar nga palët. Në vijim, kërkuari ka paraqitur vendimin e mësipërm për ekzekutim në Zyrën Përmbare Vlorë.

3. Në datën 02.12.2016 nga ana e Zyrës Përmbare Vlorë është mbajtur procesverbali i veprimeve përmbare gjatë fazës së ekzekutimit, në bazë të të cilit ka rezultuar se vendimi nr.160/1983 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat nuk gjendej pranë Zyrës Përmbare Vlorë. Sipas këtij procesverbali ka rezultuar, gjithashtu, se pranë asaj zyre gjendej vendimi nr.154, datë 08.05.1984 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat (*vendimi nr. 154/1984*) me të njëjtat palë ndërgjyqëse që janë edhe te vendimi nr.160/1983 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Në këto kushte Zyra Përmbare Vlorë ka vendosur pushimin e ekzekutimit të vendimit nr.677/2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

4. Në datën 07.12.2016 kërkuari i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me pretendimin se pala e paditur, Zyra e Përmbare Vlorë, ka vendosur pushimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor në kundërshtim me ligjin, pasi referuar shkresës nr.1613/G, datë 18.03.1986 të asaj zyre, rezulton se vendimi nr.160/1983 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat ishte duke u ekzekutuar.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr.103, datë 26.01.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuarit, si të pabazuar në ligj dhe në prova, me arsyetimin se në kushtet kur vendimi nr.160/1983 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i cili ka qenë administruar nga pala e paditur, Zyra Përmbare Vlorë, rreth vitit 1986 në kohën kur ka qenë në fazë ekzekutimi, nuk gjendej më në arkivin e saj, kërkuari mund t'i drejtohej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për të mundësuar nxjerrjen e këtij vendimi të njësuar me origjinalin. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuari.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2013 (86-2019-2334), datë 27.06.2019, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se Zyra Përmbare Vlorë në këtë proces nuk paraqitet

si organi përgjegjës i ngarkuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, arsye për të cilën nuk mund të kundërshtohen veprimet përmbarimore të kryera prej saj, pasi në rastin konkret ajo zyrë nuk vepron në këtë cilësi. Në këto kushte procedurale, gjykata e shkallës së parë ka pranuar për gjykim dhe ka shqyrtuar një padi që nuk mund të ngrihej, shkak për të cilin vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhej të prishej dhe çështja të pushohej sipas nenit 50, shkronja “d”, të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2912, datë 04.07.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Sipas Kolegjit Administrativ, kërkuesit i është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka bërë një analizë të hollësishme dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), të cilat rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim.

8. Në datën 27.11.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

9.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë legjitimuar moszbatimin nga Zyra Përmbarimore Vlorë të vendimit nr. 160/1983 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i cili është i formës së prerë. Në pamundësi për të disponuar një kopje të vendimit nr. 160/1983 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, si pasojë e djegies së godinës të kësaj gjykate, i vetmi institucion që mund t’i japë kërkuesit kopje të këtij vendimi është Zyra Përmbarimore Vlorë, pasi ajo e disponon këtë vendim. Gjatë procesit gjyqësor në të cilin është marrë vendimi nr. 677/2016 i Gjykatës Administrative të Apelit, Zyra Përmbarimore Vlorë ka qenë palë e paditur në proces dhe në asnjë moment nuk e ka kundërshtuar objektin e asaj padie dhe as nuk e ka ankimuar vendimin në gjykatën e apelit. Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish. Gjykimi nuk duhet

konsideruar ngushtësisht vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e të gjithë procesit, pasi është një e drejtë e fituar dhe nëse nuk realizohet përmes ekzekutimit të vendimit mbetet pa asnjë vlerë.

9.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk i kanë arsyetuar vendimet e tyre. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë është mjaftuar thjesht duke përmendur nenet e KPC-së, ndërkohë që nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit është vendosur pushimi i gjykimit vetëm me arsyetimin se në këtë proces Zyra Përmbartimore Vlorë nuk paraqitet si organi përgjegjës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, arsye për të cilën nuk mund të kundërshtohen veprimet përmbartimore të kryera prej kësaj zyre, pasi ajo në këtë rast nuk vepron në këtë cilësi, duke mos argumentuar se në cilën bazë ligjore është mbështetur për të arritur në këtë përfundim. Në këtë proces gjyqësor Zyra Përmbartimore Vlorë gëzonte legjitimitet pasiv, pasi dokumentet e kërkuara nga kërkuesi, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, gjenden pranë saj. Në këtë kuptim, ajo zyrë ka detyrimin që të ekzekutojë vendimin gjyqësor të formës së prerë. Edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë të gjithë arsyetimin e tij e ka përmbledhur në dy paragrafë dhe duke mos u dhënë përgjigje argumenteve të ngritura në rekurs.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të

plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në drejtim të shterimit të mjeteve juridike efektive, Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, pretendim të cilin nuk e ka ngritur as në ankimin e paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit, as në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se për këtë pretendim kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive dhe për këtë qëllim ai nuk mund të merret në shqyrtim. Ndërsa pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, kërkuesi e ka ngritur në thelb në rekurs, ndaj, për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për këtë pretendim ai e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

14. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 04.07.2024 dhe është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 01.08.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 27.11.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, i cili vlerësohet se *prima facie* përfshihet në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohet në vijim.

*B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

16. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk janë të arsyetuara. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë është mjaftuar thjesht duke përmendur nenet e KPC-së, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pushimin e gjykimit bazuar në arsytimin se në këtë proces gjyqësor Zyra Përmbare Vlorë nuk paraqitet si organi përgjegjës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, ndaj nuk mund të kundërshtohen veprimet përmbare të kryera prej saj, ndërkohë që nuk ka argumentuar se në cilën bazë ligjore është mbështetur për të arritur në këtë përfundim. Sipas kërkuesit, Zyra Përmbare Vlorë gëzonte legjitimitet pasiv në këtë proces gjyqësor, pasi dokumentet e kërkuara nga kërkuesi, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, gjendeshin pranë saj. Në këtë kuptim, ajo zyrë kishte detyrimin që të ekzekutonte vendimin gjyqësor të formës së prerë. Edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë të gjithë arsytimin e tij e ka përmbledhur në dy paragrafë, duke mos u dhënë përgjigje argumenteve të ngritura në rekurs.

17. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Po sipas Gjykatës, arsytimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka arsyetuar përmbledhtazi se gjatë gjykimit të çështjes ka rezultuar e provuar se veprimet e palës së paditur për ekzekutimin e vendimit nr. 677/2016 të po asaj gjykate janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe konkretisht me nenin 616 të KPC-së. Sipas procesverbalit të datës 01.12.2016 të mbajtur nga Zyra Përmbare Vlorë rezulton se vendimi nr. 160/1983 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat nuk gjendej pranë asaj zyre, e cila dispononte vetëm vendimin nr. 154/1984 të po asaj gjykate. Në kushtet kur vendimi nr. 160/1983 nuk ndodhej në arshivën e Zyrës Përmbare Vlorë, kjo e fundit me të drejtë ka vendosur pushimin e ekzekutimit të vendimit nr. 677/2016 të Gjykatës Administrative të

Shkallës së Parë Vlorë. Sipas gjykatës së shkallës së parë, kërkuesi mund t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për të marrë kopje të njësuar me origjinalin të vendimit (*shih faqen 5 të vendimit nr. 103, datë 26.01.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat*).

19. Gjykata Administrative e Apelit ka prishur vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe ka vendosur pushimin e çështjes, me arsyetimin se ajo gjykatë ka pranuar për gjykim dhe ka shqyrtuar një padi që nuk mund të ngrihej. Sipas gjykatës së apelit, në rastin objekt gjykimi janë ngatërruar cilësia e palës debitore në fazën e ekzekutimit të titullit ekzekutiv dhe funksioni përmbartimor gjyqësor, si organ i ngarkuar me ligj për ekzekutimin e një të drejte të fituar gjyqësisht me vendim gjyqësor të formës së prerë. Sipas gjykatës së apelit, Zyra Përmbartimore Vlorë është pala debitore, e detyruar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 677/2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për të vënë në dispozicion të palës paditëse/kreditore Polo Sino një kopje të njësuar me origjinalin të të gjithë dosjes së ekzekutimit të vendimit civil të formës së prerë nr.160/1983 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Në këtë kuptim, Zyra Përmbartimore Vlorë në këtë proces nuk paraqitet si organi përgjegjës i ngarkuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë të mësipërm dhe për këtë arsye nuk mund të kundërshtohen veprimet përmbartimore të kryera prej asaj zyre, pasi në këtë rast ajo nuk vepron në këtë cilësi (*shih faqen 10 të vendimit nr.2013 (86-2019-2334), datë 27.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit*).

20. Në vijim, pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuesi janë marrë në shqyrtim në dhomën e këshillimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili ka vlerësuar se rekursi përmban pretendime që janë shqyrtuar nga gjykatat e faktit, të cilat kanë zhvilluar proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë e të gjithanshëm të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, si dhe u kanë dhënë përgjigje shteruese të gjitha kërkimeve dhe pretendimeve të palëve të ngritura në gjykim. Ato gjykata kanë bërë një analizë tërësore dhe objektive të provave, duke i vlerësuar ato në bazë të bindjes së tyre të brendshme të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e rrethanave të çështjes dhe e duke zgjidhur mosmarrëveshjen konkrete në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Po kështu, Gjykata Administrative e Apelit ka bërë një analizë të hollësishme dispozitave të KPC-së, të cilat rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim. Nga ana tjetër, Kolegji Administrativ ka vënë në dukje faktin se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 15, 17 dhe 18 të vendimit nr. 00-2024-2912, datë 04.07.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

21. Gjykata ka ritheksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të



tilla, nuk mund të jenë objekt i këtij gjykimi kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore, raste në të cilat Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Bazuar në këto standarde kushtetuese, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor kanë të bëjnë, në thelb, me vlerësimin dhe interpretimin e ligjit nga ana e gjykatave të zakonshme, çka nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se interpretimi që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë bërë legjislacionit në fuqi dhe zbatimit të tij, në rastin në shqyrtim nuk rezulton të jetë arbitrar dhe nuk paraqet probleme në aspektin kushtetues. Po kështu, Gjykata e Administrative e Apelit u ka dhënë përgjigje të argumentuara pretendimeve të kërkuarit. Vendimi i Gjykatës së Lartë përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku parashtrohet vlerësimi i saj për vendimet e gjykatave më të ulëta. Arsyetimi i kufizuar i këtij vendimi nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv.

23. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

24. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.